



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
URDHËR

Nr. 22, datë 17.3.2016

**PËR DEPOZITIMIN E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT,  
NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT  
TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË  
FUNKSIONE PUBLIKE”**

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””,

URDHËROJ:

I. Duke filluar nga data 21.3.2016 dhe në përputhje me afatet ligjore të procesit të vetëdeklarimit, stafi politik i Kuvendit, të depozitojë pranë titullarit të institucionit formularin e vetëdeklarimit, të plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 138/2015 dhe të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016.

II. Në kuptim të pikës 1 të këtij urdhëri, stafi politik i Kuvendit përbëhet nga:

- a) kabineti i Kryetarit të Kuvendit;
- b) kabineti i zëvendëskryetarëve të Kuvendit;
- c) shërbimi i grupeve parlamentare;
- ç) shërbimi për zyrat e deputetëve në qarqe.

III. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ilir META





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
URDHËR

Nr. 23, datë 17.3.2016

**PËR CAKTIMIN E NJË STRUKTURE TË POSAÇME PËR DORËZIMIN DHE  
ADMINISTRIMIN E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT, NË ZBATIM  
TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT  
TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË  
FUNKSIONE PUBLIKE”**

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””,

URDHËROJ:

I. Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura Kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj caktohet struktura e posaçme përgjegjëse për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit për kandidatët për funksione në organet kushtetuese apo të krijuara me ligj dhe që zgjidhen nga Kuvendi dhe për funksionarët publikë aktualë, sipas neneve 5, pika 4 dhe 15 të ligjit nr. 138/2015 dhe të Kreut II, pika 4, shkronjat “c” dhe “ë” të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016.

II. Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimi të Deputetëve krijon regjistrin për regjistrimin e formularëve të vetëdeklarimit dhe merr masa për të siguruar ruajtjen dhe dokumentimin e tij në rrugë elektronike, si dhe publikimin sipas parashikimeve të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016.

III. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ilir META





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 947 Prot

Tiranë, më 17.03 2016

URDHËR

Nr. 58, Datë 17.03 2016

**PËR DEPOZITIMIN E FORMULARIT TE VETEDEKLARIMIT, NE ZBATIM TE LIGJIT NR. 138/2015 “PER GARANTIMIN E INTEGRITETIT TE PERSONAVE QE ZGJIDHEN, EMEROHEN OSE USHTROJNE FUNKSIONE PUBLIKE”**

Drejtuar: Znj./ Z. \_\_\_\_\_

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

URDHËROJ:

I. Duke filluar nga **data 21.3.2016** dhe në përputhje me afatet ligjore të procesit të vetëdeklarimit, **stafi civil i Kuvendit**, i përbërë nga nepunesit civil te nivelit ekzekutiv ( specialist), nepunesit civil te nivelit te ulet drejtues( shef sektori), nepunesit civil te nivelit te mesem drejtues( drejtor dhe keshilltar) dhe nepunesit civil te nivelit te larte drejtues( drejtor, drejtor i pergjithshem dhe sekretar i pergjithshem), **të depozitojnë pranë Departamentit te Administrates Publike, formularin e vetëdeklarimit**, të plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 138/2015 dhe të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016.

II. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**Albana SHTYLLA**

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**